# RAPORT

# I AUDITUESIT LIGJOR

# PËR FONDET E PËRFITUARA DHE SHPENZUARA GJATË VITIT KALENDARIK 2017

# PARTIA DEMOKRATIKE

Lejla Shahu
Auditues Ligjor

LEJLA SHAHU
Auditues Ligjor
Lic.174 datë.22/01/2008

## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Komisionit Qëndror Zgjedhor
Adresa: Rr.Ibrahim Rugova, Nr.4
Partia Demokratike e Shqipërisë
Adresa: Blv. Zhan D'Ark, Nr.11,Tiranë.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Partia Demokratike eShqipërisë" (OJF), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të "Partia Demokratike e Shqipërisë" (OJF) në datën 31 Dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te OJF-ve.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Partia Demokratikee Shqiperise (OJF), në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishme në auditiminepasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimittëpasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

Përgjegjësitë e Administratorëve dhe të Personave të Ngarkuar me Mbikqyrjen në lidhje me Pasqyrat Financiare1

*Raporti i auditimit është i vlefshëm vetëm për pasqyrat fiananciare bashkëngjitur tij.*

*Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.*

*Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e OJF për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë OJF ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.*

*Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OJF.*

*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

*Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.*

*Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.*

*Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ush trojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.Ne gjithashtu:*

*Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materjale, ,qoftë për shkak te mashtrimit ose gabimit ,hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve ,dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftushme dhe e pershtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të perfshijë marëveshje të thjeshta,falsifikime,përjashtime të qëllimshme, informacjone të deformuara ,anashkalime të kontrolleve të brendshme.*

*Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinjoni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të OJF-se.*

*Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmerinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkateëse të bëra nga drejtimi.*

*Raporti i auditimit është i vlefshëm vetëm për pasqyrat fiananciare bashkëngjitur tij.*

*Nxjerim një konkluzjon në lidhje me përshtatshëmrinë e përdorimit të bazës konabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të mare, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftesinë e OJF-se, per të vijuar veprimtarinë .Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financjare , ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshëm, duhët të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që OJF-ja të ndërpresë veprimtarinë.*

*Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave,lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit,përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojnë gjatë auditimit.*

***Lejla Shahu***

***Auditues Ligjor***
*Rr. Islam Alla, P.51, H.9, Tirane*
*Tel: 0673589854*

*Tirane me 20 Korrik 2018*

LEJLA SHAHU ( DOBI)
Auditues Ligjor
NIPT K 82005005 S
TIRANË - ALEANIA

LEJLA SHAHU
Auditues Ligjor
Lic.174 datë.22/01/2008

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

I. Pasqyra e Pozicionit Financiar

II. Pasqyra e Aktiviteteve (Performancës)

III. Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

IV. Informacion i përgjithshëm

V. Politikat operuese

VI. Rregullat e vlerësimit

VII. Shënime mbi Llogaritë Vjetore

**I.PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

*Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31.12.2017*

(Shumat ne ALL )

| I | AKTIVET | Shenime | 31/12/2017 | 31/12/2016 |
|---|---|---|---|---|
| | 1 Aktivet monetare | 1 | 7,427,787 | 29,555,160 |
| | 2 Te drejta dhe interesi i arketueshem | | | |
| | 3 Kontribute te arketueshme | | | |
| | 4 Inventare dhe shpenzime te parapaguara | 2 | 120,000 | 120,000 |
| | 5 Investime financiare afatshkurtra | | | |
| | 6 Aktive te kufizuara per investime | | | |
| | 7 Toka, ndertesa dhe paisje | 3 | 40,183,983 | 45,527,375 |
| | 8 Investime te tjera afatgjata | | | |
| | Totali i AKTIVEVE | | 47,731,770 | 75,202,535 |
| | | | | |
| II | DETYRIMET | | | |
| | 1.Te pagueshme | 4 | 4,750,648 | 4,134,702 |
| | 2.Deftesa te pagueshme | | | |
| | 3.Kontribute te marra ne avance | | | |
| | 4.Grante | | | |
| | 5.Premtime te kushtezuara per tu dhene | | | 470,722 |
| | 6.Huate afatgjata | | 0 | 0 |
| | Totali Detyrimeve (II) | | 4,750,648 | 4,605,424 |
| III | AKTIVET NETO | | | |
| | 1. Te kufizuara | | | |
| | a) toke ose vepra arti qeperdoren per qellime te caktuara, | | | |
| | ruhen dhe nuk shiten | | | |
| | b) aktive tedhuruara per tu investuar me qellim | | | |
| | e te krijohen burim te ardhurash prej tyre | | | |
| | 2. Te pakufizuara | 5 | 42,981,122 | 70,597,111 |
| | Totali i Aktiveve Neto (III) | | 42,981,122 | 70,597,111 |
| | Totali Detyrime dhe Aktive Neto | | 47,731,770 | 74,731,813 |

*Shenimet shoqeruese nga 8 deri ne 16 jane pjese integrale e ketyre Pasqyrave Financiare*

LEJLA SHAHU
Auditues Ligjor
Lic.174 date.22/01/2008

## II.PASQYRA E AKTIVITETEVE (PERFORMANCES)

Per vitin ushtrimor te mbyllur me 31.12.2017

(Shumat ne ALL)

| Nr | Përshkrimi i elementëve | Shenime | 31.12.2017 | 31.12.2016 |
|---|---|---|---|---|
| A) | Ndryshimi ne aktivet neto te pakufizuara: | | | |
| | Te Ardhurat: | | | |
| | 1.Te ardhurat nga tarifat e anetaresimit | 6 | 180,000 | |
| | 2.Teardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare | 6 | 22,889,253 | |
| | 3.Te ardhura nga grante qeveritare, agjensi te tjera | 6 | 108,157,230 | 57,179,867 |
| | 4.Te ardhura nga investime apo dhurime | | | |
| | 5.Tarifat dhe sherbimet | | | |
| | 6.Te ardhurat nga aktivitetet tregetare | | | |
| | 7.Te ardhura te tjera | | | |
| | Totali i te Ardhurave | | 131,226,483 | 57,179,867 |
| - | Aktive neto te cliruara nga kufizimet: | | | |
| | 1.Realizimi i kufizimeve te programit | | | |
| | 2.Realizimi i kufizimeve per blerjen e paisjeve | | | |
| | 3.Perfundimi i kufizimit te afatit | | | |
| | Totali i aktiveve te cliruara nga kufizimet | | | |
| - | Shpenzime te aktivitetit | | | |
| | 1.Aktiviteti Fushate zgjedhore per Kuvendi 2017 | 7.1 | -97,218,467 | |
| | 2.Shpenzime administrimi e te tjera te pergjithshme | 7.2 | -61,625,050 | -61,055,372 |
| | 3.Krijim dhe rritje fondesh | | | 4,188,137 |
| | Totali i shpenzimeve | | -158,843,517 | -56,867,235 |
| | Rritja/Renia ne aktivet neto te pakufizuara (A) | | -27,617,034 | 312,632 |
| B) | Ndryshimi ne aktivet neto te kufizuara | | 0 | 0 |
| | 1.Kontributet | | | |
| | 2.Te ardhurat nga investimet afatgjata | | | |
| | 3.Fitimi i realizuar nga investimet afatgjata | | | |
| | 4.Humbja nga obligacionet | | | |
| | 5.Aktivet neto te cliruara nga kufizimet | | | |
| | Rritja/Renia ne aktivet neto te kufizuara (B) | | 0 | 0 |
| C) | Ndryshimi ne Aktivet Neto (A+B) | | -27,617,034 | 312,632 |
| - | Aktivet neto ne fillim | | 70,597,111 | 70,284,479 |
| - | Aktivet neto ne fund | | 42,980,077 | 70,597,111 |

Shenimet shoqeruese nga 8 deri ne 16 jane pjese integrale e ketyre Pasqyrave Financiare

**III.PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE**

**Metoda indirekte**

*(të ushtrimit të mbyllur më datë 31.12.2017)* *(Shumat ne ALL)*

| | | 2017 | 2016 |
|---|---|---|---|
| I AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT | | | |
| Ndryshimet në aktivet neto | | (27,615,989) | 312,632 |
| Rregullimet për përputhjen e ndryshimeve në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet e | | | |
| | Amortizimi dhe zhvlerësimi | 5,343,391 | 6,244,705 |
| | Humbjet e realizuara dhe të parealizuara në investime | | |
| | Humbjet nga dalja jashtë përdorimit e makineri pajisjeve | | |
| | Kontributet jo në para | | |
| | Rritjet / Rëniet jo në para të inventarëve | | |
| | Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma | | |
| | | | |
| Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra: | | | |
| | Të tjera të arkëtueshme | | |
| | Shpenzime të parapaguara | | |
| | Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme | | |
| | Të pagueshme | 145,225 | 687,084 |
| | Bamirësi mbi baza vjetore | | |
| Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit | | (22,127,373) | 7,244,421 |
| | | | |
| II AKTIVITETET INVESTUESE | | | |
| | Blerje / Shitje investimesh | | |
| | Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata | | (2,325,522) |
| | Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme | | |
| | Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme | | |
| Flukse neto nga aktivitetet investuese | | | (2,325,522) |
| | | | |
| III AKTIVITETET FINANCUESE | | | |
| | Arkëtime nga kontributet e kufizuara për investime në dhurime / | | |
| | Principal i paguar për dëftesat e pagueshme | | |
| Flukse neto nga aktivitetet financuese | | | |
| | | | |
| Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre (I+II+III) | | (22,127,373) | 4,918,899 |
| | Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të periudhës | 29,555,160 | 24,636,261 |
| | Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të periudhës | 7,427,787 | 29,555,160 |
| | Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për interesa | | |
| | Mjete monetare të paguara gjatë periudhës për tatim taksa | | |

*Shenimet shoqeruese nga 8 deri ne 16 jane pjese integrale e ketyre Pasqyrave Financiare*

**SHENIME SHPJEGUESE**

*(të ushtrimit të mbyllur më datë 31.12.2017)*

**IV. Informacion I Përgjithshëm.**

Në dokumentacionin në Zyrën e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se me urdhër nr. 12 datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar krijimi i Partise "Partia Demokratike e Shqipërisë", me iniciale "PD" ose "PDSH". Qëllimi dhe objektivat e kësaj partie janë të përcaktuara në program dhe statut. Partia Demokratike e Shqipërisë ka për qëllim konkurimin politik përmes zgjedhjeve të përgjithshme, në respekt të vlerave të lirisë, barazisë dhe drejtësisë në një garë politike. Ajo synon të promovojë në interes të Shqipërisë dhe Shqipëtarëve, lirinë e mendimit dhe dinjitetin e individit, të drejtat dhe detyrat themelore të tyre, zhvillimin e iniciativës së lirë e barazinë në shans, tregun e lirë e konkurues si instrument për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit, shtetin e së drejtës, sigurinë e individit dhe të pronës, përgjegjësinë individuale e fuqizimin e familjes, drejtësinë shoqërore e dialogun social, ruajtjen e natyrës dhe të ambientit, autoritetin e shtetit dhe vetëqeverisjen e lirë të kolektiviteteve lokale.

Organizimi dhe drejtimi

Instancat dhe organet qëndrore të PD janë:

- Kuvendi i Partisë;
- Këshilli Kombëtar;
- Kryetari dhe zevendesit e tij;
- Kryesia e PD;
- Sekretari i përgjithshëm;

Burimet e financimit të Partisë janë:

- Të ardhurat nga kuotat e anëtarësimit
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit në perputhje me ligjislacionin për financimin e partive politike;
- Ndihmat dhe dhuratat e antaresisë dhe të përkrahësve të PD
- Çdo e ardhur tjeter qe nuk bie në kundërshtim me ligjislacionin për financimin e partive politike.

Selia e Partisë është në: Bulevardi Zhan D'Ark, nr.11, Tiranë.

Numri Identifikues Personit Tatimore(NIPT) eshte: K51919009E

**V. Politikat operuese**

Drejtimi i Partisë, ka operuar për këtë periudhe që auditojmë në pajtim me:

- ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,:i ndryshuar me ligjin 74/2012 date 19.07.2012 dhe ligin 31/2015 date 02.04.2015
- ligin nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar me ligjin 10374 datë 10.02.2011 dhe me ligjin nr.90/2017 datë 22.05.2017.
- ligjin Nr.9228 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare i datës 29.04.2004, i ndryshuar.
- dhe akte të tjera nënligjore në fuqi, në konformitet me objektin e veprimtarisë për të cilin është krijuar.

**VI.Rregullat e vleresimit**

**Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare**

Nga data 1 janar 2016 është bërë efektiv Standarti Kombëtar i Kontabilitetit për OJF-të për përgatitjen e pasqyrave financiare të hartuara në përputhjeme këtë Standart nga ato organizata te cilat kanë nje identitet ligjor të veçantë, të cilat:

- janë krijuar për të kryer aktivitet te vaçnta të një natyre bamirësie apo altruiste

- *nuk tatohen (për aqkohësa nuk kryejnë aktivitet fitimprurës)*
- *janë të ndaluar t'i ndajnë tepricat nga aktiviteti tek themeluesit dhe/ose anëtarët*
- *nuk zotërohen ose kontrollohen nga Qeveria*

*SKK për OJF-te synohet të zbatohet nga të gjitha ato organizata që kane statusin e njësive ekonomike jo fitimprurëse, vëndase apo të huaja, që kryejne aktivitet në Shqipëri. Janë objekt i këtij Standarti fondacionet, shoqatat, qëndrat, partitë politike, institucionet fetare, sindikatat dhe cdo organizatë tjetër e papërmendur ne këtë paragraf, por që ka statusin e nje organizate jo fitimprurëse, përveç atyre OJF-ve apo disa prej veprimtarive të tyre, të cilat me ligj të veçantë, përjashtohen nga detyrimi për të ndërtuar dhe raportuar pasqyrat e tyre financiare.*

*Objektivi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas këtij Standarti është dhënja e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të Partisë politike jo fitmiprurëse, të dobishëm për qëllime të përgjegjësisë dhe vendimmarjes së përdoruesve të këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit teë mjeteve monetare te Subjektit politik, vetëm dhe vetëm nëse:*

*a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;*

*b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arësyeshme e të bazuara (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); dhe*

*c) shënimet në pasqyrat financiare janë të përgatitura në detaje të maftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës dhe fluksit të mjeteve monetare të Subjektit politik, në mënyre të tille që lexuesit kompetente të mund të nxjerrin konkluzione të arësyeshme.*

*Paraqitja e vërtetë dhe e besueshme nënkupton që:*

*Parimet bazë dhe kërkesat e tjera, të paraqitura nga nenet 9 deri 12 te Ligjit të Kontabilitetit nr. 9228 si dhe paragrafët 40-90 të SKK 1 "Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare", janë përdorur si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare të Subjektit politik;*

*Aktivet, detyrimet, aktivet neto, te ardhurat dhe shpenzimet, të paraqitura në pasqyrat financiare të Subjektit politik, përmbushin kriteret e kufizimeve të dhëna në këtë standart.*

***Pozicioni Financiar***

*Pozicioni financiar i Subjektit politik është marrdhënja e aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve neto në një datë të caktuar siç paraqitet në pasyrën e pozicionit financiar.*

*a) një aktiv është një objektose e drejtë e kontrolluar nga Subjekti politik si rezultat i ngjarjeve të kaluara, nga I cili pritet të rrjedhin në të ardhmen tek Subjekti politik, përfitime ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve*

*b) një detyrim është një detyrim aktual i Subjektit politik që rrjedh nga ngjarje te shkuara, shlyerja e të cilit pritet të rezultoje në një dalje në të ardhmen nga Subjekti politik të përfitimeve ekonomike ose foma të tjera të mundshme të përfitimeve.*

*c) aktivet neto përfaqësojnë aktivet e Subjektit politik mbasi zbriten të gjitha detyrimet e saj.*

***Performanca***

*Performanca tregohet nga marrdhënja e të ardhurave dhe shpenzimeve të një Subjekti politik gjatë një periudhe raportuese.*

*Të ardhurat dhe shpenzimetpercaktohen si vijon:*

*Të ardhuratjanë rritje të perfitimeve ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve,gjatë periudhës raportuese , të cilat rezultojnë si shtim i aktiveve ose si pakësim i detyrimeve;*

*Shpenzimet janë zvoglimet në përfitimet ekonomike ose formave të tjera të mundshme të përfitimeve, gjatë perjudhës raportuese, të cilat rezultojne si pakësim i aktiveve ose si shtim i detyrimeve.*

***Aktivi***

*Aktivi është një objekt ose e drejt ekonomike e kontrolluar nga subjekti politik, i cili :*

*Ka ardhur si rezultat i ngjarjeve të shkuara;dhe*

*Nga përdorimi i të cilit priten në të ardhmen përfitime ekonomike ose forma të tjera të mundshme të përfitimeve.*

***Detyrimet***

*Detyrimet në pasqyrën e pozicjonit financjar të Subjektit politik janë detyrime aktuale të cilat:*

*Kanë lindur nga ngjarje të shkuara ;dhe*

*Shlyerja e tyre pritet të shoqërohet në të ardhmen me daljen e përfitimeve ekonomike apo të llojeve të tjera të përfitimeve të mundshme.*

***Aktivitet neto***

*Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të Subjektit politik në datën e pasqyrës së pozicjonit financjar.Aktivet neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori, ,ndahen në:*

*Aktive neto të kufizuara,dhe*

*Aktive neto të pakufizuara.*

***Paraqitja e Pasqyrave Financjare të Subjektit politik***

*Ky seksion percakton parimet për hartimin e pasqyrave financjare të organizatave jo fitimprurëse.*

*Pasqyrat financjare të Subjektit politik përbëhen nga:*

*-pasqyra e pozicjonit financjar*

*-pasqyra e aktiviteteve, dhe*

*-pasyra e fluksit të mjeteve monetare.*

*Orginizatat jo fitimpurëse japin në shënimet shpjeguese informacjone të tjera shtesë të nevojshme për të kuptuar llojin e aktiviteteve dhe shërbimeve që kryejnë.*

***Pasqyra e Pozicionit Financiar***

***Qëllimi dhe objekti i pasqyrës së pozicionit financiar***

*Qëllimi kryesor i pasqyrës së pozicionit financiar është të japë informacionin e duhur mbi aktivet, detyrimet dhe aktivet neto të Subjektit politik si dhe marrëdhënjet e tyre me njëra tjetrën në një moment te caktuar kohe. Infomacioni i dhënë në pasqyrën e pozicionit financiar i përdorur së bashku me informacionin e dhënë në shënimet shpjeguese apo informacionin e pasqyrave të tjera financiare, ndihmon donatorët, anëtarët, kreditorët dhe te tjerë përdorues të vlerësojnë,*

a) *aftësinë e Subjektit politik për të vazhduar ofrimin e shërbimeve dhe*
b) *likuiditetin e Subjektit politik, fleksibilitetin financiar, aftësinë për të shlyer detyrimet dhe nevojat për financime të jashtme*

***Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve***

*Pasqyra e pozicionit financiar, përfshirë shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, jep informacionin e duhur rreth likuiditetit, fleksibilitetit financiar dhe marrëdhënjeve mes aktiveve dhe detyrimeve te Subjektit politik, ky informacion jepetnë pasqyrë duke i bashkuar aktivet (detyrimet) me karakteristika të njëjta në grupime të arësyeshme dhe homogjene.*

***Klasifikimi i aktiveve neto të kufizuara dhe të pakufizuara nga donatorët***

*Pasqyra e pozicionit financiar e përgatitur nga Subjekti politik paraqet shumat e secilës prej dy klasave të aktiveve neto:*

*Aktive neto të kufizuara dhe*

*Aktive neto të pakufizuara:*

*Mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori.*

***Aktivet neto të kufizuara***

Brënda kategorisë së aktiveve neto të kufizuara, duhet të paraqiten në zëra të veçantë, në pasqyra apo në shënime shpjeguese, si më poshtë:

Aktivet si psh: toka apo vepra arti të dhuruara, me përcaktimin që të përdoren për qëllime specifike, të ruhen dhe të mos shiten, ose

Aktive të dhuruara me qëllim që të investohen për të siguruar një burim të përhershëm të ardhurash:

**Aktivet neto te pakufizuara**

Informacioni rreth kufizimeve kontraktuale të cilat janë të konsiderueshme dhe të rëndësishme, përfshirë angazhimeve për të marre hua, paraqitet në shënimet shpjeguese. Në mënyrë të ngjashme, informacioni rreth kufizimeve të vetvendosura që konsiderohet i rëndësishëm, përfshirë informacionin mbi ndonjë vendim të mbështetur në vullnetin e lirë të bordit drejtues të Subjektit politik për të krijuar active neto të pakufizuara sipas funksionit si dhurime (ndonjëherë te quajtura dhurata të ktijuara nga Bordi), mund të jepet në shënimet ose tek vetë pasqyrat financiare.

**Qëllimi dhe objekti i Pasqyrës së Aktiviteteve**

Qëllimi kryesor i Pasqyrës së Aktiviteteve I përdorur së bashku me shënimet shpjeguese është të japë informacionin e nevojshëm mbi:

a) efektet rreth transaksioneve të ngjarjeve apo rrethanave të tjera që çojnë në ndryshimin e shumave dhe natyrës së aktiveve neto
b) marrëdhënjet e këture transaksioneve të ngjarjeve apo rrethanave të tjera me njëra tjetrën dhe
c) si përdoren burimet e Partisë politike për të ofruar programme apo shërbime të ndryshme.

Informacioni i paraqitur në pasqyrën e aktiviteteve i përdorur së bashku me shënimet shpjeguese apo informacionin e pasqyrave të tjera, ndihmon donatorët, kreditorët e të tjerë përdorues që të:

1. vlerësojnë performancën e Partisë politike gjatë periudhës
2. vlerësojnë përpjekjet e Partisë politike për të ofruar shërbime dhe aftësinë e saj për të vazhduar në ofrimin e shërbimeve
3. vlerësojnë se si drejtuesit e Partise politike delegojnë përgjegjësitë dhe bashkëpunojnë me të tjerët
4. aspekte të tjera të performancës së organizatës.

**Kontributet e marra**

Kontributet e marra duhet të njihen si të ardhura ose fitime në periudhën kur merren si aktive, pakësim të detyrimeve apo shpenzimeve në varësi të formës së përfitimit të marrë. Kontributet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë.

Kontributet në formën e shërbimeve

Kontributet në shërbime do të njihen nëse shërbimet e përfituara

a) krijojnë ose shtojnë aktive jo financiare ose
b) kërkojnë aftësi të specializuara të ofruara nga inividë që i kanë këto aftësi dhe nëse nuk përfitoheshin si donacion do duhej të bliheshin. Shërbimet që kërkojnë aftësi të specializuara ofrohen nga arkitektë, kontabilistë, hekurthyesit, doktorët, elektricistët, avokatët, infermierët, hidraulikët, mësuesit, zejtarët dhe profesionistët e tjerë.
c) Kontributet në shërbime dhe premtime për të dhënë shërbime që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme nuk do të njihen në pasqyrat financiare.

LEJLA SHAHU
Auditues Ligjor
Lic.174 datë.22/01/2008

## VII.SHENIME MBI LLOGARITE VJETORE.

*Pasqyra e Pozicionit Financiar/ Aktivet*

### 1. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

*Aktivet dhe detyrimet në monedha të huaja jane paraqitur me vleren e drejtë perkthehen në lekë me kursin e kembimit në datën që është përcaktuar vlera e drejtë.*

*Monedhat e huaja me të cilat operon Partia jane EUR, USD dheCHF. Kursi i këmbimit zyrtar i Bankes së Shqipërisë për keto monedha kundrejt monedhës vendase lek,eshte si më poshtë:*

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| EUR | 132,95 | 135,23 |
| USD | 111,10 | 128,17 |
| CHF | 113,94 | 126,05 |

*Gjendja e mjeteve monetare në datë 31.12.2017 është në vlerën 7,427,787 lekë si mëposhtë:*

| | *31 dhjetor 2017* | *31 dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| *1.mjete monetare në bankë* | *7,383,671* | *29,136,411* |
| *2.mjete monetare në arkë* | *44,116* | *418,749* |
| ***Totali*** | ***7,427,787*** | ***29,555,160*** |

*Gjendja e detajuar e bankave më 31.12.2017 jepet nga tabela e më poshteme:*

| Nr | Llogarite bankare | LEKË | EURO | USD | CHF | Totali në lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | International Commercial Bank (ICB) | 4,105,560 | | | | 4,105,560 |
| 2 | International Commercial Bank (ICB) | | 8 | | | 1,064 |
| 3 | International Commercial Bank (ICB) | | | 1,030 | | 1[illegible],570 |
| 4 | Raiffeisen Bank (RZB) | 2,193,600 | | | | 2,193,600 |
| 5 | Raiffeisen Bank (RZB) | (1,008) | | | | (1,008) |
| 6 | Raiffeisen Bank (RZB) | | (5) | | | (965) |
| 7 | Raiffeisen Bank (RZB) | | 5,000 | | | 664,750 |
| 8 | Raiffeisen Bank (RZB) | | (21) | | | (2,850) |
| 9 | Raiffeisen Bank (RZB) | | | 202 | | 22,48[illegible] |
| 10 | Raiffeisen Bank (RZB) | | | | 1,045 | 1[illegible]9,716 |
| 11 | Credins Bank | 164,738 | | | | 164,738 |
| 12 | Credins Bank | (3,090) | | | | (3,090) |
| 13 | Credins Bank | | | 22 | | 2,405 |
| | TOTAL | 6,459,800 | 4,982 | 1,282 | 1,045 | 7,383,671 |

### 2. Invontarët dhe shpenzimet e parapaguara

*Shuma e invontarëve dhe shpenzimeve te parapaguara më 31.12.2017 është 120.000 leke, shumë e pandryshuar nga viti 2016, e cila përfaqëson vlerën e materjaleve ndihmese të Partisë.*

| | | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|---|
| 1. | Inventarë dhe | | |
| | shpenzime të parapaguara | 120,000 | 120,000 |
| | totali | 120,000 | 120,000 |

**3. Toka,ndërtesa dhe paisje**

Zëri ' Aktiveve te Pasqyrës se Pozicionit Financiar "Toka, ndërtesa dhe paisje" ësl lë paracitur me modelin e kostos në bazë të SKK nr.5 ku nje aktiv paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi. Vlera e mbetur e zërit te aktiveve "Toka. ndërtesa paisje" ne 31.12.2017 është 40,183 983. Gjatë vitit 2017 nuk ka patur shtesa apo pakësime ne zërin "Toka, ndërtesa, paisje". Totali i tyre është pakësuar me shumën 5,343,375 lekë të amortizimit vjetor të llogaritur. Drejtimi nuk ka llogaritur humbje nga zhvlerësimi per këtë zë të aktiveve të pasqyrave financiare te datës 31/12/2017

Tabela e mëposhtme na tregon vlerën e mbetur sipas zërave te investimeve afatgjata:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| 1.Ndërtesa | 23,826,519 | 25,080,546 |
| 2.Makineri,linja teknologjike, paisje | 17,205 | 21,506 |
| 3.Mjete transporti | 6,424,686 | 8,030,858 |
| 4.Mobilje orendi paisje zyre | 8,307,530 | 10,384,412 |
| 5.Programe dhe paisje informatike | 1,608,043 | 2,010,053 |
| **Totali** | **40,183,983** | **45,527,375** |

Tabela e mëposhtme na tregon shumat e amortizimit dhe përqindjet e amortizimit per zërat e investimeve afatgjata:

| | norma e amortizimit (%) | shuma e amortizimit |
|---|---|---|
| 1.Ndërtesa | 5 | 1,254,027 |
| 2.Makineri,linja teknologjike, paisje | 20 | 4,301 |
| 3.Mjete transporti | 20 | 1,606,171 |
| 4.Mobilje orendi paisje zyre | 20 | 2,076,866 |
| 5.Programe dhe paisje informatike | 20 | 402,010 |
| **Totali** | | **5,343,375** |

*Pasqyra e Pozicionit Financiar/ Detyrimet dhe Aktivet Neto*

**4.Detyrimet**

| | *31 dhjetor 2017* | *31 dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| 1.Të paqueshme | 4,750,648 | 4,605,424 |
| **Totali** | **4,750,648** | **4,605,424** |

Zëri i detyrimeve "Të paqueshme" përbëhet si më poshte:

| | *31 dhjetor 2017* | *31 dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| 1 furnitore për mallra e shërbime | 4,031,085 | 3,395,300 |
| *Top channel* | *3,561,300* | *0* |
| *Mokthin Motors* | *469,785* | *2,930,462* |
| *OSHEE* | *0* | *402,198* |
| *Driten Nelaj* | *0* | *62,640* |
| *2.Sigurime shoqerore dhe shëndetsore* | *719,563* | *739,402* |
| ***Totali*** | ***4,750,648*** | ***4,134,702*** |

**5.Aktivet Neto të Pakufizuara**

Në këtë zë është paraqitur diferenca midis aktivit dhe totalit të detyrimeve në 31.12.2017 në shumën 42,981,122 lekë, e cila përfaqson gjëndjen psurore të partisë.

| | *31 dhjetor 2017* | *31 dhjetor 2016* |
|---|---|---|
| 1.Aktive Neto të pakufizuara | 42,981,122 | 70,597,111 |
| ***Totali*** | ***42,981,122*** | ***70,597,111*** |

**Pasqyra e Aktiviteteve**

**6.Të Ardhurat**

Të ardhurat e realizuara gjatë vitit ushtrimor janë si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2017 | 31 dhjetor 2016 |
|---|---|---|
| 1.Të ardhura nga Buxheti i Shtetit | 87,274,553 | 57,179,867 |
| 2.Fonde për zgjedhjet për Kuvendin 2017 | 20,771,018 | 0 |
| 3.Dhurime në natyre | 22,889,253 | 0 |
| 4.Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit | 181,045 | 0 |
| **Totali** | **131,227,528** | **57,179,867** |

- Me Vendimin nr.28 datë 24/01/2017 Komisioni QëndrorZgjedhor ka vendosur të shpërndajë për Partinë Demokratike shumen 87,274,553 lekë në formën e ndihmës financiare për vitin 2017.
- Me Vendimin nr.341 datë 31/05/2017 Komisioni Qëndror Zgjedhor ka vendosur të shpërndajë shumën 20,771,018 lekë Partisë Demokratike si fonde publike paradhënje për pjesmarjen e saj në zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 qershor 2017.
- Me Udhezimin nr.3 datë 02/06/2017 te KQZ-së, neni 3 "Dhurime në natyrë", Partia ka kontabilizuar minutat e transmetimit televiziv falas që operatorët televizivë kanë faturuar pa pagesë në shumën 21,150,400 lekë.
  Githashtu Partia ka kontabilizuar shumën 1,738,853 lekë si dhurime në natyrë qe i përket zyrave te mara me qera dhe të vlerësuara me cmimin reference nga ekspertet financiarë.
- "Të ardhuar nga tarifat e anëtarësimit" në shumën 181,045 lekë, përfshijnë kuotizacionet e anëtarësisë të arkëtuara gjatë vitit 2017.

**7.Shpenzimet për aktivitetin**

7.1"Aktivitete – Fushatë zgjedhore për Kuvëndin 2017", në shumën 97,218,467 lekë, përfshijnë shpenzimet që ka bërë Partia tëcilat detajohen si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1. shpenzime televizive, transmetive live, spote, reklama | | 56,040,736 lekë |
| - Ku: 33,890,335 me pagesë dhe 21,150,400 falas | | |
| 2. shpenzime konsulenca | | 26,402,878 lekë |
| Muzin Capitol Partners Consulting | 3,147,500 | |
| Barners & Thournburg | 19,237,500 | |
| Clearpath Strategy llc | 1,820,109 | |
| Murphy Vogel Askew Reilly llc | 2,197,769 | |
| 3. foni, stage, ndricim | | 10,000,000 lekë |
| 4. qera zyra elektorale (dhurime në natyre) | | 1,738,853 lekë |

7.2 "Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme" në shumën 61,625,050 lekë, përfshijnë shpenzimet operacionale vjetore të Partisë, dhe detajohensi mëposhtë:

| | |
|---|---|
| 1. shpenzime paga dhe shpërblime | 25,260,922 |
| 2. sigurime shoqërore dhe shëndetsore | 4,034,604 |
| 3. shpenzime për konsulenca | 4,858,602 |
| 4. qera ambjentesh për evente | 2,514,063 |
| 5. udhëtim e dieta | 1,099,000 |

| | |
|---|---|
| 6. shpenzime postare dhe te ekomunikacion | 4,285,194 |
| 7. subvencione te dhëna | 5,000,000 |
| 8. Shpenzime të tjera | 3,924,074 |
| 9. energji, ujë | 3,404,540 |
| 10.komisione bankare | 88,703 |
| 11.kuota anëtarësimi në organizata ndërkombëtare | 790,650 |
| 12.taksa vendore | 31,250 |
| 13.shpenz me financiare | 990,068 |
| 14.shpenzime amortizimi | 5 343.391 |